

VENDIM
Nr. 109, datë 1.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 207, DATË 18.12.2017, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

(Ndryshuar me vendimin nr. 209, datë 16.12.2019)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 7, pika 1 dhe nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 104, pika 4, germa “a”; nenit 113, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, Bordi i ERE-s vendosi: miratimin e rregullores për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje me kërkesë të shoqërisë OST sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, në lidhje me realizimin e investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 270, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- ERE-s, me shkresën me nr. 398 prot., datë 13.6.2019, në zbatim dhe të vendimit nr. 270, datë 21.12.2018, i rikujton shoqërisë se në zbatim të nenit 7, “Kriteret standarde të performancës për operatorin e sistemit të transmetimit”, pika 4, në vitin 2019, ERE do të rishqyrtojë performancën e ushtruar nga shoqëria OST sh.a., gjatë viteve 2017–2018, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit për periudhën në vijim.

Për sa më sipër i kërkon shoqërisë OST sh.a. paraqitjen e të dhënave të nevojshme brenda datës 1 korrik 2019.

- Së fundmi OST sh.a., me shkresën nr. 4059/1 prot., datë 26.6.2019, në përgjigje të shkresës sonë ka përcjellë pranë ERE-s informacion për treguesit e performancës në transmetim, për vitet 2014–2018 dhe tremujorin e parë të vitit 2019, si dhe nivelin e pritshëm të performancës

Pra, siç vihet re edhe nga të dhënat e dërguara nga OST sh.a., edhe pse treguesit e performancës për sistemin e transmetimit janë përmirësuar përgjatë 2014–2018, niveli i pritshëm i performancës i konsideruar nga OST sh.a. për vazhdimin e 2019-s është relativisht i ulët krahasuar me vlerat e periudhës së mëparshme.

- Për këtë do t’i kërkohej OST sh.a. të paraqesë në vijim në ERE argumente më të detajuara.

- OST sh.a., me shkresën me nr. 6205/1 prot., datë 18.10.2018, protokolluar me tonën nr. 576/1 prot., datë 22.10.2018 lidhur me implementimin e rregullores për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, ka kërkuar shtyrjen e afateve të implementimit të rregullores deri më 1 janar 2020.

- Duke marrë në konsideratë edhe paraqitjen e planeve të investimeve të operatorit të sistemit të transmetimit konstatohet se investimet e parashikuara dhe ato që janë realizuar së fundmi shërbejnë në përmirësimin e gjendjes së rrjetit dhe elementeve të transmetimit të energjisë elektrike rrjedhimisht duke përmirësuar standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Sa përcjellë nga OST sh.a. vërehet se për nivelet e pritshme ka rritje të treguesve në vlerës negative, të pajustificuar (rritje për kohën mesatare të ndërprerjes AIT, Shtim të sasisë së energjisë të pafurnizuar ENS, periudha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit, si edhe rritje të indeksit të kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare SAIDI).

- Për të gjitha sa me sipër gjykohet e nevojshme që OST sh.a. të përcjellë në ERE një material më të plotë, me argumentet dhe shtjellimet përkatëse në lidhje me nivelin e pritshëm të performancës dhe periudhën e përmirësimit të këtyre standardeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 7.1, 7.2 dhe 9.1, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, të Bordit të ERE-s”, të pezullohen deri në miratimin nga ERE-s të niveleve të lejuara të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, sipas pikës 7.4 të po kësaj rregulloreje.

2. Pika 7.3 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OST sh.a. do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30.11.2020.

3. Pika 7.4 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, ndryshon dhe bëhet: “Brenda 6 muajve nga paraqitja e propozimit të OST sh.a., ERE do të vlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit.”.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë OST sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti